

20260951468

Në bazë të nenit 77 paragrafi (11) dhe (12), nenit 77-z paragrafi (3) dhe nenit 77-j paragrafi (2) të Ligjit për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/2019, 103/2021, 86/2025 dhe 114/2025), Këshilli i ekspertëve i Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimit pensional me financim kapital, në seancën e mbajtur më 29.4.2026, miratoi

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
AGJENTË TË SHOQËRIVE PENSIONALE**

Neni 1

Në Rregulloren për agjentë të shoqërive pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 110/2016, 184/2019 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 268/2023 dhe 83/2024), në nenin 3 paragrafi (3) fshihet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

Neni 2

Në nenin 8, në paragrafin (3), fjalët: “që është” zëvendësohen me fjalët: “ose Formulari nr. 3 që janë”.

Neni 3

Në nenin 9 paragrafi (1), fjalia e dytë fshihet.

Në paragrafin (2), fjalët: “që është” zëvendësohen me fjalët: “ose Formulari nr. 4 që janë”.

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 01-662/3
29.4.2026
Shkup

Kryetar
i Këshillit të Ekspertëve,
Remzi Bajrami, d.v.